



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Prania / Dorezuar Punëjmena/Prodato Received/Delivered	27.05.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMNSHCK	3131/2022		1/6



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.312/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.312/2022 të datës 30.03.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] ne adresë banimi [redacted] kundër organit të punësimit Autoritetit të Aviacionit Civil, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 27.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.312/2022 e datës 30.03.2022, e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja, [redacted] sipas shkresave të lëndës e punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, me datë 11.02.2022 i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së me kërkesën për kthim të kompetencave të cilat pretendon se i takojnë me ligj në cilësi të Zyrtares Kryesore Administrative (ZKA).

Ndërsa për shkak të heshtjes administrative ankuesja ka parashtruar ankesë me datë 08.03.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së me rastin e nxjerrjes së tri (3) vendimeve, respektivisht vendimit me nr.ref:45/2020 të datës 19.08.2020, vendimit me nr.ref:53/2020 të datës 24.09.2020, dhe vendimit me nr.ref:60/2020 të datës 04.11.2020 ia ka marr kompetencat që i takojnë me dispozitat e aplikuara ligjore në cilësi të Zyrtarit Kryesor Administrativ.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës me datë 06.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli me datë 19.04.2022 ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë, të cilat janë protokolluar në Këshill me numër:2193/2022.

Këshilli me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë dhe nevojës për shqyrtime shtesë dhe sqarime të mëtejme të pretendimeve ankimore të ankueses dhe palës së kundërt apo institucionit punëdhënës, me datë 06.05.2022 ka mbajtur seancë publike me palët në procedurë, ndërsa për shkak të volumit të lëndës dhe kompleksitetit të saj, Kryetari i Këshillit me datë 11.05.2022 ka nxjerre vendimin me numër:43/2022 për shtyrjen e afatit të vendosjes edhe për dhjetë (10) ditë-ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 30.03.2022 me Nr.Prot:1693/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 30.03.2022 dërguar nga ankuesja në Këshill; Kërkesën e ankueses të datës 11.02.2022 dërguar Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së; Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së i datës 19.08.2020; Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së i datës 24.09.2020; Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së i datës 04.11.2020; Rekomandimin e Këshillit të datës 27.01.2017; Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së i datës 12.01.2017 me numër ref:02/2017; Organogrami i Strukturës Organizative të AAC-së; Akt emërimi i ankueses i datës 08.06.2018; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Administratës dhe Burimeve Njerëzore; Draft-Rregulloren (AAC) Nr.XX/2021 mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistemimin e vendeve të Punës në Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës; Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së i datës 17.07.2019; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit i datës 19.07.2019; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqëse e Njësisë së Burimeve Njerëzore; Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së i datës 18.05.2020 për anulimin e rregullores së AAC-së të datës 09.07.20218; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.04.2022; Përgjigjen në kërkesë më shkresat e lëndës e datës 19.04.2022 me numër prot:2193/2022; Shënimin Zyrtar të Prokurorit të Shtetit i datës 08.01.2020; Lista e pagave të ankueses për periudhën kohore prej datës 01.02.2020 deri me datë 31.03.2022; Vendimin e datës 22.06.2020 të Kryeministrit të Kosovës për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar Kryesor Financiar i AAC-së; Vendimin e datës 17.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së me numër reference:21/2019; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 19.07.2019 lidhur me pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e Udhëheqëses së Njësisë së Shërbimit të Menaxhimit Financiar; Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së i datës 17.07.2019 me numër reference:22/2019; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës 19.07.2019 për pozitën Menaxhere e Prokurimit; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e Udhëheqës së Njësisë së Prokurimit; Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së i datës 17.07.2019 me numër reference:2019; Aktvendimi me numër AA.nr.957/2019 i Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative i datës 17.06.2020; Aktvendimin A.nr.2287/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 01.11.2019; Aktvendimin A.nr.607/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 08.10.2019; Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të AAC-së e datës 09.07.2019; Aktgjykimin C.nr.2854/2020 e Gjykatës Themelore të Prishtinës-Departamenti i Përgjithshëm i datës 19.01.2022; Rregulloren për Organizimin dhe Funkcionimin e Brendshëm dhe

Sistematizimin e Vendeve të Punës në AAC e datës 17.01.2011; Organogramin e Strukturës Organizative të AAC-së; Kërkesën e Menaxheres së Personelit të datës 06.04.2022 drejtuar Drejtorit të përgjithshëm të AAC-së; Vendimin e Këshillit A.nr.24/2022; Vendimin e Këshillit me numër A.nr.336/2020; Vendimin e Këshillit me numër A.nr.360/2020; Vendimin e Këshillit A.nr.263/2020; Vendimin e Qeverisë së Kosovës i datës 02.07.2019 me numër:06/109; Kërkesën e datës 03.08.2020 për zbatimin e vendimit të Qeverisë me numër:07/12 të datës 09.07.2020; Vendimin e Qeverisë së Kosovës i datës 09.07.2019 me numër:07/12; Ftesën për seancë publike e datës 29.04.2022 me numër prot:2538/2022; Ftesën për seancë publike e datës 29.04.2022 me numër prot:2539/2022; Procesverbalin e seancës së datës 06.05.2022 me numër A.nr.312/2022; E-mailin e datës 10.05.2022 e dërguar nga ankuesja i protokolluar në Këshill me numër:2709/2022 në cilësi të provave shtesë në përbërje prej shtatë (7) faqesh korrespondencë, E-mailin e datës 16.05.2022 e dërguar nga ankuesja i protokolluar në Këshill me numër:2809/2022 në cilësi të provave shtesë në përbërje prej katër (4) faqesh korrespondencë,

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë sikurse edhe të deklarimeve të palëve në seancën publike dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesja sipas aktit të emërimit të datës 30.06.2018 mbanë pozitën "Drejtore e Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore" në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, andaj në kuptim të nenit 33 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë ku përcaktohet se: "Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.2. Kategoria e mesme drejtuese, që përfshijn këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të", Kolegji konstaton se pozita të cilën ankuesja e ushtron sipas aktit të emërimit është e pozitë e kategorisë së mesme drejtuese.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë nenin 33 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1; 2.2; 2.3 dhe 2.4 ku përcaktohet ndarja si në vijim: "Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese, që përfshijn këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese, që përfshijn këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese, që përfshijn këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; dhe 2.4. Kategoria profesionale, që përfshijn zyrtarët profesionalë", nenin 14 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-051 për Aviacionin Civil ku përcaktohet se: "Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës ("AAC") themelohet me këtë ligj, si agjenci e pavarur rregullatore. AAC është përgjegjëse për rregullimin e sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe shërbimeve të navigimit ajror në Republikën e Kosovës. AAC ka kapacitet të plotë juridik. AAC është organizatë buxhetore dhe autoritet publik dhe i nënshtrohet dispozitave përkatëse mbi organizatat buxhetore dhe autoritetet publike në ligjet dhe aktet e tjera ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës. 14.2 AAC do të udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i Aviacionit Civil ("Drejtori i Përgjithshëm") i cili punon me orar të plotë. Drejtori i Përgjithshëm është zyrtari i AAC-së i cili është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm dhe vendimmarrjen në AAC" ndërlidhur me nenin 26 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura ku përcaktohet se: "1. Agjencia Ekzekutive dhe ajo Rregullatore organizohet si një apo disa departamente në bazë të fushëveprimtarisë. Niveli i

organizimit përcaktohet në pajtim me këtë ligj. 2. Rregullat për organizimin e brendshëm të ministrive, sipas nën paragrafëve 1.2, 1.3 dhe paragrafit 2 të nenit 15, si dhe neneve 19 deri 21 të këtij ligji, zbatohen për organizimin e brendshëm të Agjencisë Ekzekutive dhe Agjencisë Rregullatore, në përputhje me nivelin e organizimit, përcaktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni” dhe në mbështetje të nenit 1.2, 1.3 dhe paragrafit 2 të nenit 15 i të njëjtit ku përcaktohet se: “1.1. Sekretari i përgjithshëm; 1.2. departamentet, dhe 1.3. divizionet. 2. Njësitë administrative, të parashikuara në nënparagrafët 1.2. dhe 1.3 të paragrafit 1 të këtij neni, organizohen në madhësi të përshtatshme në bazë të funksionit dhe kompleksit përkatës. Si rregull, çdo nëpunës civil apo nëpunës administrativ dhe mbështetës është pjesë e një njësie administrative”, Kolegji ka konstatuar se pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së është pozitë e brazvlefshme me pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm, apo të Drejtorit Ekzekutiv të një Agjencie Ekzekutive, respektivisht është pozitë e barasvlershme me pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese, nga rrjedh se Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së është Zyrtari Kryesor Administrativ në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankueses se e njëjta duhet të jetë Zyrtare Kryesore Administrative dhe se i janë marrë kompetencat është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses se Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së me rastin e nxjerrjes së tri (3) vendimeve, respektivisht vendimit me nr.ref:45/2020 të datës 19.08.2020, vendimit me nr.ref:53/2020 të datës 24.09.2020, dhe vendimit me nr.ref:60/2020 të datës 04.11.2020 ia ka marr kompetencat që i takojnë me dispozitat e aplikuara ligjore në cilësi të Zyrtarit Kryesor Administrativ, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nenin 7 ku përcaktohet se: “Zyrtari kryesor financiar në nivelin kryesor të subjektit publik, është në vartësi të drejtpërdrejtë dhe llogaridhënës ndaj Zyrtarit kryesor administrativ për operacionet financiare, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të subjektit publik”, andaj Kolegji vlerëson se Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së me rastin nxjerrjes së vendimit me nr.ref:45/2020 të datës 19.08.2020 për mes të cilit Zyrtares Kryesore Financiare i ka ndërruar vijën raportuese ka vepruar sipas obligimeve ligjore që burojnë nga nenin 33 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe në mbështetje të nenit 14 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-051 për Aviacionin Civil ku përcaktohet se: “AAC do të udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i Aviacionit Civil (“Drejtori i Përgjithshëm”) i cili punon me orar të plotë. Drejtori i Përgjithshëm është zyrtari i AAC-së i cili është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm dhe vendimmarrjen në AAC”, andaj mbi këtë bazë pretendime ankimor se Zyrtarja Kryesore Financiare duhet t’i raportojë ankueses me pretendimin se e njëjta është Zyrtare Kryesore Administrative pasi që mban pozitë “Drejtor i Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzor”, është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar, ngase siç e kemi theksuar edhe më lartë pozita e ankueses hynë në kategorinë e mesme drejtuese.

Po ashtu, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës neni 23 paragrafi ku përcaktohet se: “ZKA i autoritetit kontraktues përcakton një person të shërbej si Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit për autoritetin kontraktues. Nëse punëtorët tjerë të autoritetit kontraktues janë nëpunës civil, Zyrtari i Prokurimit gjithashtu është nëpunës civil” si dhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik pika 11.2 përcakton se: “11.2 Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të raportoj dhe do ti jap llogari të ZKA. Nëse punëtorët tjerë të autoritetit kontraktues janë shërbyes civil, zyrtari përgjegjës i prokurimit është shërbyes civil” andaj mbi këtë bazë pretendimet ankimore se Zyrtari Përgjegjës për Prokurim Publik duhet t’i raportojë ankueses me pretendimin se e njëjta është Zyrtare Kryesore Administrative

është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar, ndërsa vendimi me nr.ref:53/2020 i datës 24.09.2020 nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së është nxjerrë në pajtueshmëri me kompetencat që ia garanton ligji material dhe të pasqyruar si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi.

Po ashtu, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë neni 14 paragrafi ku përcaktohet se: *"Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, e themeluar sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të jetë në varësi të drejtpërdrejtë të udhëheqësit më të lartë administrativ të institucionit"*, andaj mbi këtë bazë pretendimet ankimore se Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore duhet t'i raportojë ankueses me pretendimin se e njëjta është Zyrtare Kryesore Administrative është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar, ndërsa vendimi me nr.ref:60/2020 të datës 04.11.2020 nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së është nxjerrë në pajtueshmëri me kompetencat që ia garanton ligji material dhe të pasqyruara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi si dhe në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të sqarimit të hollësishëm të pretendimeve ankimore dhe vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike në pajtim me aktet e brendshme normative ka organizuara dhe mbajtur seancë publike me datë 06.05.2022 dhe ndër të tjerash sikurse edhe na bazë të provave të lëndës ka konstatuar se ankuesja sipas aktit të emërimit të datës 30.06.2018 vazhdon të mbajë pozitën *"Drejtor i Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzor"* dhe po ashtu sipas kërkesë së Këshillit të datës 06.04.2022 institucioni ka sjellë listën e pagave të ankueses për periudhën kohore që nga data 01 shkurt 2020 deri me datë 31 mars 2022 dhe kemi gjetur se ankuesja vazhdon të paguhet me pagë të njëjtë edhe pas nxjerrjes së tri (3) vendimeve nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së të kontestuara me këtë ankesë, rrjedhimisht Kolegji konstaton se ankueses i është garantuar qëndrueshmëria dhe vazhdimësia në detyrë në pajtim me parimin e përcaktuar në nenin 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë.

Ndërlidhur me pretendimet e palës ankuese se Këshilli është vënë në lajthitje me rastin e nxjerr së tri vendime (referuar specifikimit si në ankesë nga ankuesja ...SKPMSHCK/2485/202 i datës 05.11.2020, SKPMSHCK/2485/2020 i datës 05.11.2020 dhe SKPMSHCK/763/2022 i datës 14.02.2022 ), e që në rastin konkrete bëhet fjalë për dy (2) vendime pasi që njërin e ka përshkuar dy herë radhazi me numër dhe shifër të njëjtë, atij me numër A.nr.263/2020 të datës 05.11.2020 dhe A.nr.24/2022 të datës 14.02.2022, me pretendimin se Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore e ka keqpërdorur detyrën zyrtare dhe Këshillit i ka ofruar vendimeve nule, andaj ndërlidhur me këtë pretendim të ankueses Kolegji thekson faktin se vendimet e Këshillit e përmbajnë këshillën juridike dhe palët e pakënaqura udhëzohen për mundësinë e hapjes së konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa lidhur me pretendimin për veprimin e cilësuar si *"keqpërdorim i detyrës zyrtare"*, Kolegji vë në vëmendje ankuesen se shkeljet e tilla të supozuara nuk hyjnë në fushëveprimin e shqyrtimit nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, ndërsa palët në pajtim me dispozitat e aplikuara ligjore mund të hapin raste tek organet kompetente.


Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.312/2022

**Elakron GASHI**



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Eshref SHBANI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses [REDACTED]
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.